

“Diploma e fituar në FIM paraqet themelin e arritjeve jetësore për çdo të ri, ndërkaq ne jemi të gatshëm të punojmë me ju gjatë gjithë rrugëtimit tuaj profesional e akademik.”

Pranimet

Pranimet në Universitetin e Prishtinës bëhen nëpërmjet konkurseve publike. Çdo person i cili e ka përfunduar maturën shtetërore dhe i përmbush kriteret e përcaktuara në konkursin për studentë të rinj, ka të drejtë të konkurrojë për t’u bërë pjesë e Universitetit tonë.

Rreth nesh

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës aftëson studentët në lëmenjtë e inxhinierisë mekanike, të industrisë, teknologjisë, transportit dhe fushave të ndërlidhura. Përmes programeve studimore që ne ofrojmë, ju mund të siguronit pozita dhe funksione të ndryshme në industri, siç janë: projektimi, konstruktimi, prodhimi i detaleve, veglave dhe pajisjeve për nevoja të industrisë automobilistike, aviacionit, termocentrale, mirëmbajtja e riparimi i sistemeve të linjave të automatizuara dhe shërbimeve “inteligjente”, menaxhimi i cilësisë apo edhe të jeni CEO i kompanisë.



Kontakti

Adresa:

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni:

+383(0)38 552 126

Email:

fim@uni-pr.edu

Webfaqja:

<https://fim.uni-pr.edu/>



Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Kalendari akademik

15 janar	Përfundimi i ligjëratave (semestri dimëror)
15 janar – 15 shkurt	Provimet e semestrit dimëror
15 shkurt	Dita e Universitetit të Prishtinës
16 shkurt	Fillimi i semestrit veror
31 maj	Përfundimi i ligjëratave për vit akademik
Korrik	Konkursi për studimet bachelor
Shtator	Konkursi për studimet master
15 shtator	Përfundimi i vitit akademik
1 tetor	Fillimi i vitit akademik



Programet:

Bachelor

Mekatronikë (180 ECTS)
Komunikacion dhe Transport (180 ECTS)
Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme (180 ECTS)
Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment (180 ECTS)
Dizajn Inxhinierik dhe Automjete (180 ECTS)

Master

Mekatronikë (120 ECTS)
Komunikacion Rrugor (120 ECTS)
Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërishme (120 ECTS)
Dizajn Inxhinierik dhe Automjeteve (120 ECTS)

Pse në FIM?

- Programet më unike të studimit – institucioni i vetëm i arsimit të lartë, ofertues i programeve studimore në Inxhinieri Mekanike;
- Profesorë me përvojë dhe eminentë në fushat përkatëse;
- Mundësi të shumta për studime njësemestrale në universitete evropiane;
- Diplomë që njihet ndërkombëtarisht;
- Tarifa të ulëta studimi;
- Kampus atraktiv;
- Laboratorë dhe qendra hulumtuese bashkëkohore;
- Bursa për studentët me arritje të larta;
- Partneritete të shumta me tregun e punës, të cilat krijojnë mundësi për: punë praktike, vende pune dhe ngritje në karrierë;
- Të diplomuar me punësueshmëri të lartë.

